REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PROJEKT-VENDIM
Nr. 28, Date 24/04/2025

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË EMERGJENCAVE CIVILE NË BASHKINË DEVOLL PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", Vendim Nr. 923, datë 25.11.2020 "Për funksionimin e organizimin e komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhetë strukturave të sistemit të mbrojtjes civile" Vendimit Nr.158 datë 17.03.2021 "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore". Vendimi Nr.654 datë 18.12.2002''Për përcaktimin e tarifave për përdorimin e përkohshëm nga Organet Shtetërore në situatë Emergjente, të çdo mjeti privat''
Vendimi Nr.531 datë 01.08.2003 ''Për organizimin,funksionimin,detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të Emergjencave Civile''.

PROPOZOJ:

1. Miratimin e Planit të emergjencave Civile në Bashkinë Devoll.për vitin 2025 bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij projektvendimi sektori I Emergjencave civile,
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.*

Konceptoi: Yllson STENA

Miratoi: Marsel MULLA

Konfirmoi bazueshmërinë ligjore: Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve
Eriksela AVDO

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1420 **Prot.** **Bilisht, më** 30.4 **2025**

RELACION

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË EMERGJENCAVE CIVILE NË BASHKINË DEVOLL PËR VITIN 2025"

Ne zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar , Ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", Vendimit Nr.158 datë 17.03.2021 "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore".

Plani i Emergjencave Civile përshkruan punën e bërë dhe detyrimet që rrjedhin në nivel lokal,bazuar në Ligjin Nr.45\2015 "Për Mbrojtjen civile".

Bashkia Devoll përballet me një shumëllojshmëri rreziqesh, si zjarret në pyje dhe kullota, bllokimi i rrugëve nga dëbora, tërmetet ,sëmundjet infektive dhe ndryshimet klimatike. Duke parë shumëllojshmërinë e problemeve që përballet Bashkia Devoll,,ky dokument i hartuar ka një rëndësi të madhe sepse organizohet sistemi i menaxhimit të Emergjencave Civile dhe krizave.

Qëllimi kryesor është të kemi një plan efektiv për Bashkinë Devoll, ku detyrat dhe përgjegjësitë në rast emergjence të jenë të përcaktuara për ti ardhur në ndihmë komunitetit në një kohë sa më të shpejtë dhe efikase.

Plani i Bashkisë për Emergjencat Civile dhe Krizat është një dokument praktik i hartuar nëpërmjet një procesi konsultimesh me një sërë institucionesh,për të arritur qëllimin për të cilin është krijuar,mbrojtjen e popullsisë ,gjësë së gjallë,pronës,trashëigimisë kulturore dhe mjedisin nga të gjitha llojet e rreziqeve.

Në të janë përcaktuar të gjitha fazat e ciklit të Emergjencave Civile,duke filluar me parapërgatitjen,përgjigjen ndaj situatave të krijuara duke vazhduar me rikthimin në gjëndjen normale dhe lehtësimin e pasojave.

Ky dokument siguron kushtet për institucionet shtetërore,publike dhe private për veprimtarinë ekonomike dhe për popullatën,për kalimin nga gjendja normale e jetës dhe punës në një situatë emergjente,me humbje sa më të vogla në jetë njerëzish dhe gjësë së gjallë,të pronës dhe trashëgimisë kulturore.

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

Nëpërmjet këtij plani krijohen rrugët e komunikimit dhe të shkëmbimit të informacionit të duhur, forcimi i vëmendjes dhe nëpërmjet bashkërendimit, arrihet forcimi i kapaciteteve të përgjigjes në të gjitha fazat e ciklit të emergjencave civile.Nga zbatimi i këtij plani dhe bashkëpunimi i të gjitha institucionet do të arrihet të shpëtohen sa më shumë jetë njerëzish dhe pasuri,do të sigurohen mjetet për kërkimin e burimeve dhe ndihmës shtesë.

Plani përfshin të dhëna dhe informacion nga të gjitha institucionet në një mënyrë të përshtatshme.

Plani do të mbetet një punë në progres,për të qënë në gjendje të kapërcejë ndryshimet në mjedisin e jashtëm dhe krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet nga fatkeqësitë natyrore,për të parandaluar,përgatitur dhe përballuar fatkeqësitë dhe për t'u rimëkëmbur nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile'

Konceptoi: Yllson STENA

Miratoi: Marsel MULLA

KRYETARI
Eduard DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com